



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në pajtim me Nenet 3.4, 15.1 dhe 21.2, të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të rregullimit të operimeve me deltaplan, deltaplan me motor, paraglajd dhe paraglajd me motor brenda territorit të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 1/2012 PËR
KUSHTET DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË DELTAPLANËVE DHE
PARAGLAJDËVE**

**Neni 1
Fushëveprimi**

1.1 Kjo rregullore përcakton:

- a) prodhimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e deltaplanëve dhe paraglajdëve;
- b) vendet për ngritje dhe aterrim të deltaplanëve dhe paraglajdëve;
- c) rregullat dhe kufizimet për deltaplanët dhe paraglajdët; dhe trajnimin, ekzaminimet, licencat dhe autorizimet për pilotët e deltaplanëve dhe paraglajdëve.

1.2 Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me deltaplanët që kontrollohen kryesisht nga sipërfaqet e lëvizshme aerodinamike gjithashtu janë të aplikueshme për glajderët me peshë deri në 80/100 kg.

**Neni 2
Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje, përkufizimet dhe shkurtesat e përdorura këtu kanë kuptimet si në vijim:

AIP (Aeronautical Information Publication) -Publikim i Informatave Aeronautike,

FAI (Federation Aeronautique Internationale)-Federata Ndërkombëtare Aeronautike,

Manovrim SAT (Safety Aerobatic Team) -manovrim akrobatik (Ekipi akrobatik i sigurisë) në të cilin boshti i rrotullimit është ndërmjet krahut dhe pilotit,

SIV (Simulation d'Incident de Vol) simulimi i incidenteve gjatë fluturimit,

VMC (Visual Meteorological Conditions)-Kushtet Vizuele Meteorologjike

"I/e pranuar/i pranueshëm" -do të thotë nuk kundërshtohet nga AAC-ja si i përshtatshëm për qëllimin e synuar;

"I/e aprovuar" do të thotë i/e dokumentuar nga AAC-ja si i përshtatshëm për qëllimin e synuar;

"Fluturim akrobatik" (*Aerobatic flight*)-nënkupton një manovrim të qëllimshëm i cili përfshin ndryshim të vrullshëm të pozitës së mjetit ajror, pozitë të pazakonshme, apo përsheptim të pazakonshëm të mjetit ajror, që nuk është i nevojshëm për një fluturim normal;

"Mjet ajror" (*Aircraft*)-do të thotë çdo mjet i cili mbështet në atmosferë nga reaksionet e ajrit, përveç reaksioneve të ajrit përkundrejt sipërfaqes së tokës;

"Inspektor i mjetit ajror"-do të thotë personi i cili është përgjegjës për inspektimin në lidhje me lëshimin, ri-lëshimin/përtëritjen e lejes për fluturim, në emër të AAC-së në përputhje me standardet e përcaktuara nga AAC-ja;

"Fushë ajrore" (*Airfield*)-nënkupton aerodromin i cili nuk ka pista me sipërfaqe të fortë dhe i cili nuk shfrytëzohet për fluturimet ndërkombëtare;

"Trajnim i aprovuar"-do të thotë trajnimi i cili kryhet sipas kurrikulit dhe mbikëqyrjes së veçantë të aprovuar nga AAC-ja;

"AAC"-nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës të themeluar sipas Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil;

"Autorizim"-nënkupton dëshminë e trajnimit shtesë të pilotëve të deltaplanëve apo paraglajdëve, e cila është e regjistruar në licencën e pilotit;

"Instruktor i autorizuar i fluturimit"-nënkupton pilotin e deltaplanit apo paraglajdit me autorizimin valid të instruktorit të fluturimit, që operon në kuadër të organizatës së aprovuar të trajnimit për trajnimin e pilotëve të deltaplanëve apo paraglajdëve;

"Menaxher/organizator i autorizuar i aktivitetit të planifikuar"-nënkupton personin përgjegjës për përgatitjen, organizimin, ekzekutimin dhe kontrollin e sigurt të aktiviteteve të organizuara të fluturimit me deltaplanë dhe paraglajdë;

"Kandidat (aplikues)"-nënkupton aplikuesin për ekzaminimin (teorik dhe/apo praktik (fluturim)) për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit apo të autorizimit përkatës;

"Certifikatë për kryerjen e trajnimit"-nënkupton certifikatën e organizatës së aprovuar të trajnimit, për kryerjen e trajnimit teorik dhe/apo praktik për pilotët nxënës;

"Kompetencë"-nënkupton kombinimin e shkathtësive, njohurive dhe qëndrimeve që kërkohen për të kryer një detyrë sipas standardit të përcaktuar;

"Hapësirë ajrore e kontrolluar" (Controlled Airspace)-nënkupton Hapësirën ajrore e cila është deklaruar si hapësirë ajrore e Klasës A, B, C, D dhe E;

"Zonë e kontrolluar (CTR)" (Control zone (CTR))-nënkupton një hapësirë ajrore e cila zgjatet nga sipërfaqja e tokës deri në një limit të caktuar;

"Fluturim tërthor vendit" (Cross-Country flight)-nënkupton llojin e fluturimit në distancë i cili kryhet me mjet ajror me motor në segmente përgjatë distancës së dhënë dhe në operime ndërmjet dy pikave duke përdorur teknika të navigimit; dhe me mjet ajror pa motor (paraglajd, deltaplan) duke përdorur rrymat përpjetëse për të fituar lartësinë për një fluturim me kohë të zgjatur.

"Kohë e udhëzimit të dyfishtë" (Dual instruction time)-nënkupton kohën e fluturimit apo kohën e fluturimit të simuluar në tokë gjatë së cilës personi pranon udhëzime të fluturimit nga një instruktor i autorizuar në mënyrë të duhur.

"Ekzaminues" (Examiner)-nënkupton personin që kryen provimin praktik në lidhje me lëshimin e licencës për të drejtuar deltaplanin apo paraglajdin në emër të AAC-së në përputhje me standardet e përcaktuara nga AAC-ja;

"Kohë e fluturimit" (Flight time)-nënkupton kohën e përgjithshme nga momenti i lëvizjes së parë të mjetit ajror për qëllim të ngritjes deri në momentin kur ai përfundimisht ndalet në fund të fluturimit;

"Ditar i fluturimeve" (Flight logbook)-nënkupton regjistrin personal të fluturimeve të pilotit apo pilotit nxënës të deltaplanëve apo paraglajdëve;

"Glajder" (Glider)-nënkupton mjetin ajror më të rëndë se ajri me krah të fiksuar që është në gjendje të qëndroj pezull në fluturim dhe i cili nuk ka mjete të forcës shtytëse;

"Glajder me motor" (Motor Glider)-nënkupton mjetin ajror më të rëndë se ajri me krah të fiksuar i cili është i pajisur me mjete të forcës shtytëse, është në gjendje të qëndroj pezull në fluturim pa shtytje nga mjetet e forcës shtytëse;

"Deltaplan" (Hang-glider)-nënkupton glajderin që është në gjendje të bartet, të lansohet me këmbë dhe të aterroj vetëm duke i shfrytëzuar këmbët e pilotit;

"Vend për aterrim" (Landing Site)-nënkupton lokacionin në tokë që është i përcaktuar për aterrimin e deltaplanëve apo paraglajdëve;

"Deltaplan me motor" (Powered Hang-glider)-nënkupton deltaplanin i cili ka të montuara mjete të forcës shtytëse që janë në gjendje për ta lansuar atë dhe për ta mbështetur fluturimin;

"Paraglajd" (Paraglider)-nënkupton glajderin e varur pa konstruksion themelor të ngurtë;

"Paraglajd me motor" (Powered Paraglider)-nënkupton paraglajdin me mjete të forcës shtytëse që janë në gjendje për ta lansuar atë dhe për ta mbështetur fluturimin;

"Glajder me peshë deri në 80/100 kg"-nënkupton glajderin, duke i përfshirë ata që lansohen me këmbë nga piloti, pesha maksimale e të cilëve kur janë të zbrazët nuk mund të jetë më e madhe se 80 kg për glajderët me një ulëse, apo 100 kg për glajderët me dy ulëse;

"Lëshim (p.sh. i licencës apo autorizimit të pilotit)-nënkupton procedurën administrative e cila kryhet gjatë vlefshmërisë së licencës apo autorizimit e cila i lejon mbajtësit të licencës t'i ushtroj privilegjet që i jep licenca apo autorizimi, për një periudhë të caktuar kohore, pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara;

"Listë e ekspertëve"-nënkupton listën e ekspertëve nga fushat përkatëse të aktiviteteve të aviacionit të përcaktuar nga AAC-ja;

"Riparim i madh" (Major repair)-nënkupton riparimin, i cili sipas udhëzimeve për mirëmbajtje duhet të kryhet vetëm nga prodhuesi apo organizata e autorizuar për të kryer inspektime dhe mirëmbajtje teknike;

"Fluturim i organizuar" (Organised flying)-nënkupton fluturimin me deltaplan dhe me paraglajd për qëllim të:

- a) garës sportive apo ngjarjes aeronautike,
- b) fluturimit të grupit prej pesë apo më shumë pilotësh të deltaplanëve dhe paraglajdëve,
- c) trajnimit praktik (fluturimit);

“Licencë e pilotit - (deltaplan apo paraglajd)”-nënkupton dokumentin i cili i mundëson mbajtësit të tij t'i kryej detyrat e pilotit të deltaplanit apo paraglajdit në përputhje me autorizimet e shkruara në licencë dhe varësisht prej llojit të licencës në posedim;

“Zonë e ndaluar” (Prohibited area)-nënkupton pjesën e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës brenda së cilës asnjë person nuk mund të drejtojë mjetin ajror pa lejen e agjencisë përkatëse.

“Aerodrom publik” (Public aerodrome)-nënkupton aerodromin e aprovuar nga AAC-ja e Kosovës i cili është i hapur për publikun sipas kushteve të veçanta të përcaktuara.

“Ripërtëritje (p.sh. e autorizimit apo aprovimit)” (Renewal (of e.g. a rating or approval))-nënkupton procedurën administrative të ndërmarrë pasi që autorizimi apo aprovimi të ketë skaduar e cila i ripërtërin privilegjet e autorizimit apo aprovimit për një periudhë të caktuar pasuese pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara.

“Zgjatje e vlefshmërisë (p.sh. e autorizimit apo aprovimit)” (Revalidation (of e.g. a rating or approval))-nënkupton procedurën administrative të ndërmarrë brenda periudhës së vlefshmërisë së autorizimit apo aprovimit që i lejon mbajtësit vazhdimin e ushtrimit të privilegjeve të autorizimit apo aprovimit për një periudhë të caktuar pasuese pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara.

“Mjet ajror sportiv” (Sport aircraft)-nënkupton mjetin ajror me ekuipazhin e fluturimit, më të rëndë se ajri, me apo pa motor (mjetin ajror mikro të lehtë, deltaplanin, paraglajdin, etj);

“Pilot nxënës” (Student pilot)-nënkupton personin i cili kualifikohet për marrjen e licencës së pilotit për deltaplan apo paraglajd;

“Vend për ngritje” (Take-off Site)-nënkupton lokacionin në tokë që është i përcaktuar për ngritjen e deltaplanëve dhe paraglajdëve;

“Deltaplan apo paraglajd tandem” (Tandem hang-glider or paraglider)-nënkupton deltaplanin apo paraglajdin të destinuar për fluturim të njëkohshëm të dy personave;

“Ditar i trajnimit” (Training logbook)-nënkupton regjistrin personal të pilotëve nxënës në të cilin ata i kanë futur lëndët e mësimin dhe vrojtimit në kursin e trajnimit;

“Fazë e parë e trajnimit” (The first stage of training)-nënkupton procesin e trajnimit të pilotëve nxënës që kryhet në fillim të trajnimit të tyre kur i fluturojnë deltaplanët apo paraglajdët, duke kryer fluturime në lartësi të vogla dhe të mesme;

“Fazë e dyta e trajnimit” (The second stage of training)-nënkupton procesin e trajnimit të kryer pas përfundimit të fazës së parë të trajnimit të pilotëve nxënës në fluturimin e

deltaplanëve dhe paraglajdëve, i cili merr fund me kalimin e provimit për marrjen e licencës së pilotit;

“Vend për trajnim” (Training Site)-nënkupton terrenin natyror apo të rregulluar për trajnimin e pilotëve nxënës, duke e bërë të lehtë për ngritjen, fluturimin dhe aterrimin, pa barriera apo pengesa tjera që mund të pengojnë apo rrezikojnë sigurinë e fluturimit.

Neni 3

Qëllimi i përdorimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve

3.1 Deltaplanët dhe/apo paraglajdët duhet të përdoren vetëm në përputhje me qëllimet e përshkruara në udhëzimet e prodhuesit për deltaplanët dhe paraglajdët.

3.2 Deltaplanët dhe paraglajdët duhet të përdoren për:

- a) fluturime sportive;
- b) gara, dhe
- c) trajnime.

Neni 4

Të drejtat dhe përgjegjësitë e pilotëve të deltaplanëve dhe paraglajdëve

4.1 Pilotët e deltaplanëve apo paraglajdëve duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, dispozitat e kësaj Rregulloreje, dhe dispozitat e çfarëdo Rregulloreje tjetër përkatëse të lëshuar nga AAC-ja.

4.2 Pilotët e deltaplanëve apo paraglajdëve do të drejtojnë deltaplanët apo paraglajdët në rrezikun e vet.

4.3 Pilotët e deltaplanëve dhe paraglajdëve do të jenë përgjegjës gjatë gjithë kohës për drejtimin e deltaplanëve apo paraglajdëve dhe për çdo pasojë që mund të rezultojë nga përdorimi i tyre.

4.4 Pilotët e deltaplanëve apo paraglajdëve duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar siguri gjatë ngritjes, fluturimit dhe aterrimin.

4.5 Pilotëve të deltaplanëve apo paraglajdëve u kërkohet shfrytëzim i drejtë i pajisjeve në përputhje me qëllimet e tyre dhe udhëzimet e prodhuesit në aso mënyre që siguron fluturim të sigurt.

4.6 Para trajnimit apo fluturimit, instruktori i fluturimit apo piloti tandem duhet t'i informojë pilotët nxënës që fluturojnë apo udhëtarët që fluturojnë se ata do të fluturojnë me deltaplan apo paraglajd në rrezikun e tyre.

Neni 5

Prodhimi i deltaplanëve apo paraglajdëve

5.1 Prodhim i deltaplanëve apo paraglajdëve konsiderohet prodhimi serik i deltaplanëve apo paraglajdëve nga prodhuesi.

5.2 AAC-ja pranon çfarëdo lloji të deltaplanëve apo paraglajdëve nga prodhuesit e referuar në paragrafin 1 të këtij neni me dëshminë e përmbushjes së kërkesave dhe standardeve të aplikueshme të referuara në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

5.3 Para pranimit të një lloji të ri të deltaplanit apo paraglajdit, është e rëndësishme që prodhuesi t'i ve në dispozicion të AAC-së manualët e përditësuar të fluturimit, mirëmbajtjes dhe riparimit.

5.4 Secili deltaplan apo paraglajd i prodhuar duhet të ketë të paraqitur, në një vend të përhershëm dhe në madhësi të mjaftueshme, lehtë të lexueshëm dhe lehtë të qasshëm, emrin e prodhuesit, etiketën e prodhuesit, etiketën e atestimit, numrin e modelit, vitin e prodhimit dhe numrin serik.

5.5 Prodhuesit e deltaplanëve apo paraglajdëve bashkë me secilin mjet ajror të prodhuar duhet t'i dorëzojnë shfrytëzuesit udhëzimet për fluturim dhe mirëmbajtje.

Neni 6

Ndërtimi amator

Deltaplani apo paraglajdi i ndërtuar nga një amator ekzaminohet ekskluzivisht nga ndërtuesi apo piloti testues i deltaplanit apo paraglajdit i autorizuar në mënyrë të rregullt.

Neni 7

Verifikimi teknik

7.1 Verifikimi teknik i deltaplanëve apo paraglajdëve duhet të kryhet për të përcaktuar përshtatshmërinë teknike të deltaplanëve apo paraglajdëve për të siguruar aftësinë për fluturim të sigurt.

7.2 Verifikimi teknik i deltaplanëve apo paraglajdëve kryhet nga prodhuesi apo personi juridik apo fizik i pranuar nga AAC-ja.

7.3 AAC-ja pranon personin juridik apo fizik të referuar në paragrafin 2 të këtij neni me kusht që prodhuesi t'i ketë lëshuar dëshminë e kompetencës teknike për të kryer inspektimin e deltaplanëve apo paraglajdëve.

7.4 Verifikimi teknik i deltaplanëve apo paraglajdëve duhet të bëhet në përputhje me standardet e përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

7.5 Verifikimi teknik duhet të bëhet brenda pesë (5) viteve për deltaplanët, apo brenda dy (2) viteve për paraglajdët, apo siç përcaktohet ndryshe nga prodhuesi, nga data e prodhimit të deltaplanit apo paraglajdit, apo nga data e verifikimit të fundit teknik, cilado që aplikohet.

7.6 Pa marrë parasysh afatet kohore të referuara në Paragrafin 5 të këtij Neni, verifikimi teknik duhet të kryhet pas çdo riparimi të madh apo modifikimi të deltaplanit apo paraglajdit.

7.7 Deltaplani apo paraglajdi mund të përdoret vetëm nëse verifikimi teknik ka konstatuar se është i sigurt dhe në gjendje për të fluturuar.

Neni 8

Certifikata e përputhshmërisë

8.1 Pas përfundimit të verifikimit teknik, prodhuesi apo personi juridik apo fizik i pranuar nga AAC-ja për të kryer verifikimin teknik, lëshon certifikatën e përputhshmërisë për deltaplanin apo paraglajdin.

8.2 Standardet e parapara për Certifikatën e përputhshmërisë janë përcaktuar në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje. Përveç kësaj, data e verifikimit teknik, data e verifikimit të ardhshëm teknik dhe nënshkrimi e vula e personit i cili e ka kryer verifikimin teknik, duhet të vendosen në krahun e deltaplanit apo paraglajdit.

8.3 Certifikata e përputhshmërisë lëshohet në dy kopje. Një kopje i lëshohet pronarit të deltaplanit apo paraglajdit, ndërsa kopja tjetër mbetet tek prodhuesi apo personi juridik apo fizik i cili ka kryer verifikimin teknik dhe ajo duhet të arkivohet në mënyrë të duhur.

Neni 9

Mirëmbajtja

9.1 Deltaplani apo paraglajdi, si edhe pjesët tjera të pajisjeve që kërkohen për fluturim, duhet të mirëmbahen në përputhje me udhëzimet për mirëmbajtje dhe në përputhje me vërejtjet e përcaktuara në Certifikatën e përputhshmërisë të lëshuar pas përfundimit të verifikimit teknik.

9.2 Riparimet e mëdha apo modifikimet e deltaplanëve apo paraglajdëve bëhen vetëm nga prodhuesi apo nga personi juridik apo fizik i pranuar nga AAC-ja për kryerjen e verifikimeve teknike dhe riparimeve.

Neni 10

Kushtet, aprovimi dhe evidentimi i vendeve për ngritje dhe aterrim

10.1 Vendet për ngritje dhe aterrim duhet të mundësojnë ngritje dhe aterrim të sigurt të deltaplanëve dhe paraglajdëve.

10.2 AAC-ja mban evidencën e vendeve për ngritje dhe aterrim. Vendet për ngritje dhe aterrim shfrytëzohen për aktivitet e organizuara të fluturimit të deltaplanëve apo paraglajdëve, vetëm nëse AAC-ja ka lëshuar një aprovim paraprak për shfrytëzimin e tyre.

10.3 Përveç kërkesës për aprovimin e vendit për ngritje dhe aterrim, operatori duhet të dorëzojë:

- a) opinionin e personit nga lista e ekspertëve mbi pranueshmërinë e lokacionit të përzgjedhur për qëllimin e kërkuar;
- b) pëlqimin e pronarit apo shfrytëzuesit të tokës në të cilën gjendet vendi për ngritje apo aterrim;
- c) aprovimin e autoriteteve kompetente komunale;
- d) nëse vendi për ngritje apo aterrim gjendet në një zonë të mbrojtur (park nacional), opinionin e ministrisë përkatëse në lidhje me ndikimin që vendi për ngritje apo aterrim mund ta ketë nga pikëpamja e mbrojtjes së mjedisit;
- e) aprovimin e operatorit të aerodromit, nëse vendi për ngritje apo aterrim është vendosur në zonën e aerodromit. Nuk lejohet vendi për ngritje apo aterrim në hapësirën ajrore të kontrolluar;
- f) udhëzimet për shfrytëzimin e vendit për ngritje apo aterrim që përmbajnë:
 - i) informatat e përgjithshme:
 - qëllimi i vendit për ngritje apo aterrim,
 - pozita e vendit për ngritje apo aterrim,
 - forma dhe madhësia e vendit për ngritje apo aterrim,
 - rrugët për qasje në vendin për ngritje apo aterrim,
 - emri dhe adresa e operatorit për vendin për ngritje apo aterrim,
 - ii) shënjinin e vendit për ngritje apo aterrim:
 - vendi për ngritje,
 - vendi për aterrim,
 - iii) karakteristikat meteorologjike,
 - iv) organizimin e fluturimit:
 - fluturimi në zonën e vendit për ngritje apo aterrim,
 - vendi alternativ për aterrim,
 - koordinimi dhe menaxhimi i trafikut ajror kur vendi për ngritje apo aterrim është vendosur në apo afër aeroportit ekzistues publik,
 - v) sigurimin e fluturimit:
 - përshkrimi i pajisjeve në vendin për ngritje apo aterrim, nëse ka ndonjë,
 - ofrimi i asistencës emergjente mjekësore,
 - pajisjet për meteorologji,
 - procedurat për rastet emergjente,

- vi) hartat,
- harta topografike me shkallë 1:50.000 me lokacionin e shënuar të vendit për ngritje apo aterrim dhe të zonës përkatëse për shfrytëzim të hapësirës ajrore,
 - skica e vendit për ngritje apo aterrim me një shkallë të përafërt prej 1:5.000,
- vii) pëlqimin e Qendrës së Kontrollit të Trafikut Ajror në lidhje me pozitën e vendit për ngritje dhe aterrim.

10.4 Aplikuesve që i plotësojnë kërkesat e kësaj Rregulloreje iu lëshohet aprovimi për shfrytëzimin e vendit për ngritje apo aterrim.

10.5 Operatori është i obliguar të vendosë një tabelë me karakteristikat e vendit për ngritje dhe aterrim, numrat e telefonit për njoftimin e shfrytëzimit të tij, dhe numrat e telefonit për thirrjet emergjente. Pilotët e deltaplanit apo paraglajdit duhet të njoftojnë operatorin e vendit për ngritje apo aterrim dhe të kërkojnë aprovim për shfrytëzimin e tij.

Neni 11 **Vendet për trajnim**

11.1 Pa marrë parasysh dispozitat e nenit 10 të kësaj Rregulloreje, ngritja dhe aterrimi i deltaplanëve dhe paraglajdëve për qëllime të trajnimit, mund të bëhet edhe në vendet për trajnim.

11.2 Nuk nevojitet aprovimi i AAC-së për vendet për trajnim, ku diferenca në lartësi në mes të vendit për ngritje dhe aterrim është më pak se 150 m dhe ku piloti në çdo kohë të fluturimit, nuk është më shumë se 50 m mbi tokë.

11.3 Ngritja dhe aterrimi i deltaplanëve apo paraglajdëve në vendet për trajnim lejohet vetëm me pëlqimin e pronarit apo shfrytëzuesit të tokës.

11.4 Shfrytëzimi i vendeve për trajnim në një hapësirë ajrore të kontrolluar nuk lejohet.

Neni 12 **Operimet me deltaplanë dhe paraglajdë**

Operimet që përdorin deltaplanët dhe paraglajdët bëhen në:

- a) Kushtet meteorologjike vizuale (VMC),
- b) Hapësirë ajrore të pakontrolluar të Klasës G, sipas Publikimit të Informatave Aeronautike (AIP), të Republikës së Kosovës,
- c) Zonën e aerodromit, parapraakisht të aprovuar nga operatori i aerodromit,

- d) Hapësirën ajrore të kontrolluar me një autorizim të veçantë të lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Neni 13 **Lartësitë e fluturimit**

13.1 Deltaplanët apo paraglajdët duhet të fluturojnë në lartësi mbi lartësinë minimale të sigurisë. Lartësia minimale e sigurisë është lartësi që siguron se në rast emergjence nuk do të ketë kërcënim të panevojshëm ndaj personave apo objekteve në tokë apo mbi ujë.

13.2 Me deltaplanët apo paraglajdët mund të fluturohet nën lartësinë e 150 metrave (500 shputa/feet) mbi tokë apo ujë, nëse është e nevojshme për shkak të llojit të fluturimit, me kusht që ai nuk paraqet rrezik ndaj njerëzve dhe objekteve në tokë apo mbi ujë.

13.3 Deltaplanët apo paraglajdët duhet të fluturohen në lartësi prej së paku 50 metrave (150 shputa) mbi urat, rrugët, hekurudhat, linjat elektrike, ashensorët e skijimit, antenat dhe strukturat e ngjashme dhe grupet e njerëzve.

Neni 14 **Kufizimet**

Me deltaplanët apo paraglajdët ndalohet të fluturohet:

- a) mbi zonat e deklaruar të ndaluara,
- b) në kushte të pafavorshme të motit,
- c) në re,
- d) në largësinë vertikale prej më pak se 150 m (500 shputa) nën bazën e reve,
- e) nën ura dhe objekte të ngjashme, linja elektrike të transmisionit dhe antena.

Neni 15 **Rregullat e fluturimit**

15.1 Për ngritje duhet të aplikohen rregullat në vijim:

- a) Ngritja në hapësirën ajrore rreth pikës startuese duhet të jetë e papenguar.
- b) Distanca në mes të dy deltaplanëve apo paraglajdëve dhe intervali kohor në mes të ngritjeve në të njëjtën pikë duhet të jetë e tillë që të garantojë ngritje të sigurt.

15.2 Për përballëkalim duhet të aplikohen rregullat në vijim:

- a) Kur dy deltaplanë apo paraglajdë fluturojnë në të njëjtën lartësi apo afër së njëjtës lartësi me njëri tjetrin, të dy deltaplanët apo paraglajdët duhet të kthehen në anën e djathtë, ashtu që distanca në mes tyre të jetë së paku 50 metra;
- b) Kur dy deltaplanë apo paraglajdë fluturojnë në të njëjtën lartësi apo afër së njëjtës lartësi me njëri tjetrin dhe me pjerrtësi anash tyre, përparësi ka ai me pjerrtësinë në anën e tij të djathtë. Deltaplani apo paraglajdi me pjerrtësi në anën e tij të majtë duhet të kthehet në të djathtë të pjerrtësisë për të siguruar distancën e nevojshme ndërmjet tyre prej së paku 50 metrave.

15.3 Për tejkalim duhet të aplikohen rregullat në vijim:

- a) Deltaplani apo paraglajdi më i ngadalshëm ka përparësi;
- b) Kur deltaplani apo paraglajdi që fluturon më shpejtësi më të madhe ajrore, takon, përparësi ka në të njëjtën lartësi, deltaplanin apo paraglajdin tjetër që fluturon në të njëjtin drejtim me shpejtësi më të vogël ajrore, ai mund ta tejkalojë atë duke u kthyer djathtas;
- c) Deltaplani apo paraglajdi nuk duhet të tejkalojë deltaplanin apo paraglajdin tjetër afër pjerrtësive nëse pjerrtësia është e vendosur në anën e djathtë në raport me drejtimin e fluturimit;
- d) Nëse pjerrtësia është në anën e majtë në raport me drejtimin e fluturimit, tejkalimi lejohet, me kusht që deltaplani apo paraglajdi që fluturon me shpejtësi më të madhe ajrore e tejkalon deltaplanin apo paraglajdin me shpejtësi më të ultë ajrore nga ana e djathtë.

15.4 Për kryqëzimin e vijave të fluturimit të deltaplanëve apo paraglajdëve duhet të aplikohen rregullat në vijim:

- a) Me kryqëzim të vijave të fluturimit nënkuptohet kur vija e fluturimit të një deltaplani apo paraglajdi kryqëzohet me vijën e fluturimit të një deltaplani apo paraglajdi tjetër në kënd prej 70 deri në 160 shkallëve;
- b) Kur ndodhë kryqëzimi i vijave të fluturimit të deltaplanëve apo paraglajdëve që fluturojnë përparësi ka në të njëjtën lartësi, përparësi ka deltaplani apo paraglajdi që vjen nga ana e djathtë e deltaplanit apo paraglajdit tjetër. Deltaplani apo paraglajdi që nuk ka përparësi duhet të kthehet në mënyrë që t'ia lëshojë rrugën atij që ka përparësi.

15.5 Për fluturimin në të njëjtën shtyllë termike duhet të aplikohen rregullat në vijim:

- a) Kur disa deltaplanë apo paraglajdë, fluturojnë në të njëjtën shtyllë termike, përparësi ka ai që ka filluar rrotullimin i pari;

- b) Deltaplanët apo paraglajdët duhet të rrotullohen në të njëjtin drejtim (majtas apo djathtas).

15.6 Për aterrim duhet të aplikohen rregullat në vijim:

- a) Kur disa deltaplanë apo paraglajdë janë duke aterruar, në një interval të shkurt kohor, në të njëjtin vend për aterrim, përparësi ka ai që gjendet në lartësinë më të ultë, përveç nëse një deltaplan apo paraglajd tjetër është:
- në fazën finale të aterimit, apo
 - në rrezik.
- b) Në të gjitha situatat tjera gjatë fluturimit, duhet të aplikohen dispozitat e Rregullave të ajrit ashtu siç janë paraparë në Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

Neni 16

Pajisjet e nevojshme

16.1 Pajisjet vijuese duhet të përdoren gjatë gjithë kohës për operimin me deltaplan apo paraglajd:

- a) **Helmeta:** Gjatë fluturimit, personi që drejton deltaplanin apo paraglajdin duhet të mbajë helmetë të përshtatshme mbrojtëse;
- b) **Parashuta për shpëtim:** Deltaplani apo paraglajdi nuk guxon të fluturohet më lartë se 10 metra mbi tokë nëse mjeti ajror ose piloti nuk ka parashutë për shpëtim. Parashuta për shpëtim duhet të ripaketohet së paku një herë në vit apo më shpesh nëse ashtu e saktëson prodhuesi. Ripaketimin e bënë personi i autorizuar nga prodhuesi apo personi i autorizuar për ripaketimin e parashutave për shpëtim. Ripaketimi konfirmohet duke e shkruar datën në librin e servisimit të parashutës dhe duke u nënshkruar nga personi që e ka kryer ripaketimin;
- c) **Radio-komunikimi:** Gjatë trajnimit të fluturimit, piloti nxënës duhet të ketë lidhje të radio-komunikimit me instruktorin e fluturimit;
- d) **Matësi i lartësisë (altimeter):** Kur personi që drejton deltaplanin apo paraglajdin fluturon në lartësi mesatare apo të larta, në veçanti gjatë mbi-fluturimeve, duhet të ketë pajisje për matjen e lartësisë.

Neni 17

Menaxheri / organizatori i autorizuar i aktivitetit të planifikuar

17.1 Çdo aktivitet i fluturimit i organizuar me deltaplan apo paraglajd duhet të mbikëqyret nga menaxheri/organizatori i autorizuar i aktivitetit të planifikuar. Menaxheri/organizatori i autorizuar i aktivitetit të planifikuar duhet të jetë i moshës madhore dhe duhet të ketë licencë të vlefshme të pilotit të deltaplanit apo

paraglajdit, dhe kur fluturon me pilotët nxënës ai/ajo duhet të ketë autorizim të vlefshëm të instruktorit të fluturimit.

17.2 Detyrat e menaxherit/organizatorit të autorizuar të aktivitetit të planifikuar janë si në vijim:

- a) Verifikimi i kushteve atmosferike në vendin për ngritje, apo kur është e parashikueshëm, edhe në vendin për aterrim;
- b) Bashkërendimi me ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror;
- c) Marrja e vendimeve për fillimin, ndërprerjen apo përfundimin e aktivitetit të fluturimit;
- d) Kujdesi për rregullin dhe disiplinën në vendin për ngritje, apo kur është i parashikueshëm, edhe në vendin për aterrim;
- e) Para fluturimit, kontrolli i dokumentacionit të fluturimit të personave që dëshirojnë të fluturojnë;
- f) Para fluturimit, inspektimi vizuel i deltaplanëve apo paraglajdëve për gjendjen teknike dhe pajisjet e përdorura;
- g) Ndalimi i përdorimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve me defekt;
- h) Ndalimi i fluturimit të personit, kur konstaton që:
 - ai/ajo nuk është mendërisht apo fizikisht i aftë për të fluturuar,
 - ai/ajo është qartë nën ndikimin e alkoolit, drogës apo substancave tjera të ndaluara,
 - ai/ajo i shkel rregullat e fluturimit, apo ndryshe rrezikon sigurinë e fluturimit.

17.3 Detyrat e menaxherit/organizatorit të autorizuar të aktivitetit të planifikuar të referuara në paragrafin 2 të këtij Neni duhet të aplikohen edhe për instruktorët e fluturimit gjatë trajnimit praktik (fluturimit), me kusht që instruktori i fluturimit është përgjegjës edhe për:

- a) kontrollimin nëse nxënësit për licencë të pilotit për deltaplan apo paraglajd janë të regjistruar në evidencat e nxënësve dhe të pajisur me pajisjet e kërkuara,
- b) ndarjen e detyrave pilotëve nxënës në kuadër të programeve të aprovuara të trajnimit dhe mbikëqyrjen e fluturimeve të tyre me deltaplan dhe paraglajd.

Neni 18 **Fluturimi akrobatik**

18.1 Fluturimi akrobatik lejohet vetëm nëse deltaplani apo paraglajdi është i dizajnuar për fluturime të tilla, apo në përputhje me udhëzimet e prodhuesit për llojin e veçantë të deltaplanit apo paraglajdit.

18.2 Fluturimi akrobatik mbi fshatra, rrugë, hekurudha, teleferikë, linja elektrike, ndërtesa dhe grupe të njerëzve ndalohet.

18.3 Fluturimet akrobatike, përveç atyre në paragrafin 2 të këtij Neni duhet të kryhen mbi lartësinë minimale të sigurisë.

Neni 19 Trajnimi

19.1 Kandidati duhet ta përfundojë trajnimin teorik dhe praktik (fluturimin) për marrjen e licencës së pilotit për deltaplan apo paraglajd apo të autorizimit përkatës sipas programit të aprovuar, në organizatën e aprovuar për trajnim të pilotëve për deltaplan dhe paraglajd. Nëse kandidati e ka përfunduar trajnimin teorik dhe praktik (fluturimin) në një organizatë të aprovuar për trajnim jashtë Republikës së Kosovës, AAC-ja do të përcaktojë nëse programi sipas të cilit është kryer trajnimi i plotëson kërkesat e parapara në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.

19.2 Programet kornizë për trajnimin teorik dhe praktik (fluturimin) për marrjen e licencës së pilotit për deltaplan dhe paraglajd apo të autorizimit përkatës janë paraparë në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje. Sipas këtyre programeve kornizë, secila organizatë e trajnimit zhvillon programin e vet të hollësishëm të trajnimit. Programi i tillë i trajnimit duhet të pranohet nga AAC-ja.

19.3 Para pranimit nga AAC-ja, programi i hollësishëm i trajnimit duhet të vlerësohet nga organizata e cila e kryen trajnimin, apo personi përgjegjës për trajnimin brenda organizatës duhet të përcaktojë dhe deklarojë:

- a) Përputhjen e programit të trajnimit me nevojat dhe kapacitetet e organizatës së trajnimit,
- b) Përputhjen e programit të trajnimit me këtë Rregullore, me programin kornizë të trajnimit dhe me standardet në fuqi,
- c) Nevojën periodike për modifikimin apo ndryshimin e programit të trajnimit, së paku një herë në vit për të vërtetuar efektshmërinë e tij, adoptimin ndaj nevojave dhe kapaciteteve të organizatës dhe respektimin e standardeve në fuqi.
- d) Para trajnimit, kandidati i mitur duhet t'i dorëzojë organizatës së aprovuar për trajnim të pilotëve për deltaplan apo paraglajd aprovimin me shkrim të prindit apo kujdestarit.

Neni 20 Pilotët nxënës

20.1 Para fluturimit të parë me instruktor të autorizuar të fluturimit, piloti nxënës duhet të jetë së paku 15 vjeç.

20.2 Nën mbikëqyrjen e instruktorit të autorizuar të fluturimit, deltaplani apo paraglajdi mund të drejtohet nga piloti nxënës, me kusht që ai/ajo i nënshtrohet trajnimit për marrjen e licencës për deltaplan apo paraglajd, apo nga kandidati i cili i nënshtrohet trajnimit për marrjen e autorizimit përkatës dhe i cili është i regjistruar në librin e evidencës së pilotëve nxënës në organizatën e aprovuar të trajnimit.

20.3 Njësitë mësimore dhe vërtetimet gjatë trajnimit duhet të shënohen në ditarin e trajnimit apo në ditarin e pilotëve nxënës, përkatësisht.

20.4 Piloti nxënës mund të fluturojë, vetëm nëse e posedon certifikatën e vlefshme mjekësore të lëshuar në përputhje me Rregulloren nr. 1/2010 për Kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit.

Neni 21

Përvoja e nevojshme

21.1 Kandidati që kërkon licencën e pilotit për deltaplan apo paraglajd duhet t'i ketë së paku 10 orë kohë të përgjithshme të fluturimit si pilot nxënës në deltaplan apo paraglajd, duke përfshirë së paku:

- a) 60 fluturime të suksesshme, secili nga ta me kohëzgjatje më të madhe se 5 minuta, nga të cilët më shumë se 30 fluturime mund të bëhen në mënyra të ndryshme të ngritjes nga mënyra në të cilën kandidati do t'i nënshtrohet provimit, nëse organizata e aprovuar e kryen trajnimin i cili përmban mënyra të ndryshme të ngritjes,
- b) 3 fluturime nga të cilët secili me kohëzgjatje prej së paku 2 orëve.

Neni 22

Provimi për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit

22.1 Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit, kandidati duhet të jetë së paku 16 vjeç.

22.2 Provimi për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit përbëhet nga provimi teorik dhe praktik (fluturimi).

22.3 Në përputhje me privilegjet të cilat i merr bartësi i licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit, kandidati duhet të demonstrojë nivelin e njohurive teorike nga lëndët vijuese:

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)
- b) Konstruksioni dhe materialet

- c) Meteorologjia
- d) Rregullat dhe legjislacioni
- e) Teknikat e fluturimit
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e jashtëzakonshme
- g) Dhënia e ndihmës së parë.

22.4 Verifikimi i njohurive teorike bëhet me shkrim. Pyetjet i përzgjedhin ekzaminuesit nga katalogu i pyetjeve.

Neni 23 **Provimi teorik**

23.1 Kandidati duhet t'i nënshtrohet tërë pjesës teorike të provimit për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit apo të autorizimit përkatës, të organizuar dhe zhvilluar nga AAC-ja.

23.2 Për t'iu nënshtrohet pjesës teorike të provimit, kandidati duhet të ketë rekomandimin me shkrim të organizatës së aprovuar për trajnim të pilotëve të deltaplanit apo paraglajdit, në të cilën është zhvilluar trajnimi, pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha elementeve të nevojshme të trajnimit teorik. Rekomandimi i lëshuar nga organizata e aprovuar për trajnim të pilotëve për deltaplan apo paraglajd është i vlefshëm 12 muaj. Nëse gjatë kësaj periudhe kandidati nuk i nënshtrohet provimit teorik, ai/ajo duhet të ofrojë dëshmi për trajnimin shtesë të kryer nga organizata e aprovuar për trajnim të pilotëve për deltaplan apo paraglajd.

23.3 Kandidati e kalon me sukses pjesën teorike të provimit nëse ka arritur së paku 75% të numrit të poenëve të përcaktuar për secilën lëndë. Poenët ipen vetëm për përgjigjet e sakta.

23.4 Kandidati duhet të përsërisë tërë provimin teorik nëse pas tentimit të katërt nuk e ka kaluar ndonjë lëndë, apo nëse ka skaduar periudha prej 18 muajve kalendarik prej se aplikuesi ka aplikuar për herë të parë për provim. Para ri-aplikimit për pjesën teorike të provimit kandidati duhet, në përputhje me rekomandimet e AAC-së, të kryejë trajnime shtesë në organizatën e aprovuar për trajnim të pilotëve për deltaplan apo paraglajd.

23.5 Sukses i pjesës teorike të provimit është i vlefshëm për periudhën prej 24 muajve nga data e kryerjes me sukses të tërë provimit teorik nga kandidati. Nëse gjatë kësaj periudhe kandidati nuk i nënshtrohet provimit praktik (fluturimit), atëherë ai/ajo duhet ta përsërisë provimi teorik në tërësinë e tij.

Neni 24

Provimi praktik (fluturimi)

24.1 Para aplikimit për provimin praktik (fluturimin) për marrjen e licencës së pilotit për deltaplan apo paraglajd apo të autorizimit përkatës, aplikuesi duhet të kalojë me sukses provimin teorik.

24.2 Për të aplikuar për provimin praktik (fluturimin), kandidati duhet të ketë rekomandimin me shkrim nga organizata e aprovuar e trajnimit për fluturim me deltaplan apo paraglajd, në të cilën është kryer trajnimi, pas përfundimit me sukses të të gjitha elementeve të nevojshme për trajnimin praktik (fluturimin).

24.3 Kandidati që merr licencën apo autorizimin duhet të demonstrojë me sukses nivelin e kompetencës si pilot i deltaplanit apo paraglajdit, duke i zhvilluar procedurat dhe ushtrimet përkatëse në përputhje me privilegjet e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit apo të autorizimit përkatës.

24.4 Lloji i njëjtë i deltaplanit apo paraglajdit, në të cilën kandidati ka kryer trajnimin, do të shfrytëzohet në provimin praktik (fluturim).

24.5 Provimi praktik (fluturimi) është i ndarë në disa seksione që paraqesin fazat e ndryshme të fluturimit me deltaplan apo paraglajd. Përmbajtja e provimit praktik (fluturimit) është dhënë në Shtojcën 3 të kësaj Rregulloreje. Kandidati duhet të kalojë me sukses të gjitha pjesët e seksioneve. Nëse kandidati nuk e kalon një seksion, ai/ajo mund t'i nënshtrohet përsëri atij seksioni. Do të konsiderohet që nuk e ka kaluar me sukses provimin praktik (fluturimin), nëse kandidati nuk e kalon më shumë se një seksion të provimit.

24.6 Do të konsiderohet që nuk e ka kaluar me sukses provimin praktik (fluturimin), nëse gjatë ri-nënshtimit të provimit kandidati nuk e kalon cilindo seksion, duke i përfshirë edhe seksionet që janë kaluar me sukses në tentimet e mëhershme.

24.7 Nëse gjatë dy tentimeve paraprake kandidati nuk i ka kaluar me sukses të gjitha seksionet e provimit praktik (fluturimit), ai/ajo dërgohet për trajnim praktik (fluturim) shtesë, sipas rekomandimeve me shkrim të ekzaminuesit.

Neni 25

Aplikimi, zgjatja apo ripërtëritja e vlefshmërisë e licencës apo e autorizimit përkatës

25.1 Aplikimi për lëshimin e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit apo autorizimit përkatës, dhe zgjatjen apo ripërtëritjen e vlefshmërisë së autorizimit përkatës i parashtrohet AAC-së në formën dhe mënyrën e përshkruar nga AAC-ja. Aplikimi shoqërohet me dëshmi të përmbushjes së kushteve për pilotë të deltaplanit

apo paraglajdit dhe/apo autorizim të duhur, apo për zgjatjen apo ripërtëritjen e vlefshmërisë së autorizimit përkatës siç është përcaktuar me këtë Rregullore dhe me Rregulloren nr. 1/2010 për Kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit.

25.2 Çfarëdo kufizimi apo zgjerimi i privilegjeve i cili jepet me licencë apo autorizim përkatës duhet të regjistrohet në licencë dhe certifikohet nga AAC-ja.

25.3 AAC-ja nuk i lëshon, në të njëjtën kohë, më shumë se një licencë të vlefshme për pilot të deltaplanit apo paraglajdit të njëjtit person.

25.4 Licenca për pilot të deltaplanit apo paraglajdit lëshohet në formën e definuar me Aneksin 5 të kësaj Rregulloreje.

Neni 26 **Ushtrimi i privilegjeve**

26.1 Privilegj i mbajtësit të licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit është drejtimi i pavarur i deltaplanit apo paraglajdit.

26.2 Ushtrimi i privilegjeve të dhëna bartësit të licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit mund t'i nënshtrohet kufizimeve apo autorizimit, dhe vlefshmërisë së certifikatës mjekësore.

26.3 Privilegjet e bartësit të licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit kufizohen në fluturimet për operime jo komerciale deri në përmbushjen e kushteve vijuese:

- a) mosha madhore;
- b) përvoja e fluturimit prej së paku 100 orë fluturimi dhe 100 ngritje e atertime;
- c) verifikimi i aftësive për fluturim nga ekzaminuesi i autorizuar.

26.4 Pavarësisht kushteve të paragrafit 3 të këtij Neni, bartësi i licencës së pilotit të deltaplanit dhe paraglajdit me autorizim të instruktorit të fluturimit mund të pranojë kompensim për:

- a) trajnimin e kandidatëve për licencë të pilotit të deltaplanit apo paraglajdit apo për autorizim përkatës,
- b) verifikimin e aftësive të fluturimit të bartësit të licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit apo të autorizim përkatës.

26.5 Privilegjet e bartësit të licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit janë të kufizuara vetëm në kushtet VMC gjatë ditës.

Neni 27

Obligimi i mbajtjes së dokumenteve dhe ofrimit për inspektim

27.1 Mbajtësi i licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit gjithmonë duhet të mbajë me vete licencën e tij/saj të vlefshme dhe certifikatën e vlefshme mjekësore kur ushtron privilegjet e lejuara me licencë.

27.2 Pilotët apo pilotët nxënës të deltaplanit apo paraglajdit gjithmonë duhet të mbajnë me vete dokumentet e tyre të identifikimit për identifikim më të lehtë.

27.3 Piloti apo piloti nxënës i deltaplanit apo paraglajdit gjithmonë duhet t'i ofrojë përfaqësuesit të autorizuar të AAC-së dokumentet e përmendura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni dhe ditarin e fluturimeve.

27.4 Gjatë fluturimeve solo, piloti nxënës gjithmonë duhet të ketë me vete autorizimin me shkrim të instruktorit të fluturimit për kryerjen e fluturimeve solo në deltaplan apo paraglajd.

Neni 28

Ditari i fluturimeve

28.1 Piloti apo piloti nxënës i deltaplanit apo paraglajdit duhet t'i shënojë të gjitha detajet e fluturimeve në ditarin e fluturimeve në formën dhe mënyrën siç është përshkruar në Shtojcën 4 të kësaj Rregulloreje.

28.2 Përgjegjësia për vërtetësinë e shënimeve në ditarin e fluturimeve i mbetet pilotit apo pilotit nxënës të deltaplanit apo paraglajdit dhe instruktorit të fluturimit, i cili i certifikon shënimet në ditar.

Neni 29

Revokimi, suspendimi dhe kufizimet e licencave dhe autorizimeve

29.1 AAC-ja mund të revokojë, suspendojë apo kufizojë licencën e pilotit të deltaplanit apo paraglajdit dhe autorizimin përkatës, të lëshuar në përputhje me këtë Rregullore, nëse konstatohet që piloti nuk i plotëson kushtet e përcaktuar në këtë Rregullore, Rregulloren nr. 1/2010 për Kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit apo në ndonjë akt tjetër ligjor kombëtar i cili është i aplikueshëm.

29.2 Kur AAC-ja vendos të revokojë, të suspendojë apo të kufizojë licencën e pilotit të deltaplanit apo paraglajdit dhe/apo autorizimin përkatës, piloti i deltaplanit apo paraglajdit menjëherë dhe pa vonesë duhet t'ia kthejë licencën AAC-së.

Neni 30

Zgjerimi i privilegjeve për mënyrën tjetër të ngritjes

30.1 Privilegjet e dhëna me licencën e pilotit të deltaplanit apo paraglajdit kufizohen në mënyrën e ngritjes që aplikohet në provimin praktik (fluturim). Ky kufizim largohet atëherë kur piloti i deltaplanit apo paraglajdit kryen trajnim shtesë në një organizatë të aprovuar për pilotët e deltaplanit apo paraglajdit në përputhje me programin kornizë nga Shtojca 2 e kësaj Rregulloreje.

30.2 Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit për zgjerimin e privilegjeve, organizata e aprovuar për trajnim të pilotëve të deltaplanit apo paraglajdit lëshon certifikatën për qëllime të shënimit në licencë të privilegjeve të zgjeruara.

Neni 31

Mbajtja e vlefshmërisë së licencave

31.1 Licencat e pilotëve të deltaplanit dhe paraglajdit lëshohen pa ndonjë datë të skadimit.

31.2 Bartësi i licencës ka të drejtë në shfrytëzimin e privilegjeve që jepen me licencën e pilotit të deltaplanit apo paraglajdit nëse gjatë 24 muajve të fundit ai/ajo ka kryer së paku 8 orë kohë të fluturimit dhe 15 ngritje e atertime.

31.3 Nëse piloti i deltaplanit apo paraglajdit dështon në përmbushjen e kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij Neni, para se t'i marrë privilegjet e dhëna, ai/ajo duhet të kalojë testin e shkathtësive (fluturimit) nën mbikëqyrjen e ekzaminuesit të fluturimit të deltaplanit apo paraglajdit.

Neni 32

Marrja dhe zgjatja e vlefshmërisë së autorizimeve

32.1 Piloti i deltaplanit apo paraglajdit mund të marrë autorizimet në vijim:

Autorizimin »I«: instruktor i fluturimit i deltaplanit/paraglajdit,
Autorizimin »D«: pilot tandem i deltaplanit/paraglajdit,
Autorizimin »T«: pilot testues i deltaplanit/paraglajdit,
Autorizimin »A«: fluturim akrobatik me deltaplan/paraglajd.

32.2 Periudha e vlefshmërisë e secilit autorizim është katër (4) vjet.

32.3 Për zgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit, aplikuesi duhet të dorëzojë si në vijim:

- a) dëshminë e kryerjes të së paku 40 orëve kohë të fluturimit në deltaplan/paraglajd gjatë periudhës së vlefshmërisë së autorizimit, me kusht që ai/ajo në secilin vit kalendarik duhet të ketë të kryer së paku 10 orë kohë të fluturimit,
- b) certifikatën që dëshmon se ai/ajo ka pranuar udhëzime të njohurisë teorike në organizatën e aprovuar të trajnimit të pilotëve të deltaplanit/paraglajdit,
- c) certifikatën e gjendjes shëndetësore.

32.4 Nëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së autorizimit piloti nuk i plotëson kushtet e përcaktuara, autorizimi do të pushojë së qenuri i vlefshëm derisa të plotësohen kushtet.

Neni 33

Autorizimi për instruktor të fluturimit

33.1 Piloti i deltaplanit/paraglajdit mund të kryejë trajnim të pilotëve nxënës vetëm nëse ai/ajo ka autorizim përkatës të instruktorit të fluturimit.

33.2 Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e autorizimit të instruktorit të fluturimit, aplikuesi duhet të jetë së paku 18 vjeç dhe duhet të jetë bartës i licencës së pilotit të deltaplanit/paraglajdit për së paku dy (2) vite, dhe duhet të ketë përfunduar së paku 100 orë kohë të fluturimit dhe të ketë kryer së paku dhjetë (10) fluturime të ndryshme në deltaplan apo paraglajd përkatësisht, nga të cilët dy (2) fluturime duhet të jenë më të gjata së 50 km.

33.3 Gjatë trajnimit për marrjen e autorizimit për instruktor të fluturimit, aplikuesi duhet të kryejë trajnim shtesë teorik e praktik (fluturim) sipas programit të trajnimit në një organizatë të aprovuar të trajnimit për pilotët e deltaplanit apo paraglajdit.

33.4 Pjesa teorike dhe praktike (fluturimi) e provimit për marrjen e autorizimit për instruktor të fluturimit për deltaplan/paraglajd përmban elementet e saktësuara në Shtojcën 3 të kësaj Rregulloreje.

33.5 Privilegji i bartësit të licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit me autorizimin e instruktorit të fluturimit kufizohet në mbajtjen e trajnimit teorik dhe praktik (fluturimit) për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit nën mbikëqyrjen e mentorit të fluturimit, derisa bartësi të ketë përmbushur si në vijim:

- a) së paku tri ligjërata të pavarura,
- b) të ketë asistuar në 10 seanca të veçanta të trajnimit me nxënës.

Kufizimi hiqet pas plotësimit të kushteve të parapara dhe bazuar në rekomandimin e instruktorit të fluturimit i cili e ka mbikëqyrur bartësin.

33.6 Privilegji i bartësit të autorizimit të instruktorit të fluturimit kufizohet sipas mënyrës së ngritjes dhe autorizimeve të shënuara në licencën e pilotit të deltaplanit/paraglajdit.

Neni 34 **Autorizimi për fluturim akrobatik**

34.1 Piloti i deltaplanit apo paraglajdit mund të kryejë fluturime akrobatike vetëm nëse ai/ajo posedon autorizimin përkatës.

34.2 Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e autorizimit për fluturim akrobatik, aplikuesi duhet të jetë së paku 18 vjeç, duhet të ketë licencën e pilotit të deltaplanit/paraglajdit për së paku dy (2) vite dhe të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej së paku 100 orëve të fluturimit në deltaplan përkatësisht në paraglajd.

34.3 Gjatë trajnimit për marrjen e autorizimit për fluturim akrobatik, aplikuesi duhet të kryejë trajnim shtesë teorik e praktik (fluturim) sipas programit të aprovuar të trajnimit në një organizatë të aprovuar për autorizimin e pilotëve të deltaplanit/paraglajdit.

34.4 Pjesa teorike dhe praktike (fluturimi) e provimit për marrjen e autorizimit për fluturim akrobatik në deltaplan/paraglajd përmban elementet e saktësuara në Shtojcën 3 të kësaj Rregulloreje.

Neni 35 **Autorizimi për pilot tandem**

35.1 Piloti i deltaplanit apo paraglajdit mund të kryejë fluturime si pilot tandem vetëm nëse ai/ajo posedon autorizimin përkatës.

35.2 Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e autorizimit për pilot tandem, aplikuesi duhet të jetë së paku 18 vjeç, duhet të posedojë licencën e pilotit të deltaplanit/paraglajdit për së paku dy (2) vite dhe duhet të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej së paku 100 orëve të fluturimit në deltaplan përkatësisht në paraglajd, dhe të ketë kryer së paku dhjetë fluturime të ndryshme në deltaplan përkatësisht paraglajd.

35.3 Gjatë trajnimit për marrjen e autorizimit për pilot tandem, aplikuesi duhet të kryejë trajnim shtesë teorik e praktik (fluturim) sipas programit të aprovuar të trajnimit në një organizatë të aprovuar për trajnimin e pilotëve të deltaplanit apo paraglajdit.

35.4 Pjesa teorike dhe praktike (fluturimi) e provimit për marrjen e autorizimit për pilotë tandem në deltaplan apo paraglajd përmban elementet e saktësuara në Shtojcën 3 të kësaj Rregulloreje.

35.5 Nëse piloti tashmë posedon autorizimin e instruktorit të fluturimit apo autorizimin e pilotit testues për deltaplan përkatësisht për paraglajd, pjesa teorike e provimit të tij/saj për autorizimin për pilot tandem për deltaplan apo paraglajd i pranohet.

Neni 36 **Autorizimi për pilot testues**

36.1 Piloti i deltaplanit apo paraglajdit mund të kryejë fluturime si pilot testues vetëm nëse ai/ajo posedon autorizimin përkatës.

36.2 Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e autorizimit për pilot testues, aplikuesi duhet të jetë së paku 18 vjeç, duhet të posedojë licencën e pilotit të deltaplanit/paraglajdit për së paku dy vite dhe duhet të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej së paku 200 orëve të fluturimit në deltaplan përkatësisht në paraglajd, nga të cilat së paku 100 orë të fluturimit në deltaplan përkatësisht në paraglajd i cili është i dedikuar për gara, dhe të ketë kryer së paku 20 orë të fluturimit në secilin nga pesë llojet e ndryshme të deltaplanëve përkatësisht paraglajdëve.

36.3 Gjatë trajnimit për marrjen e autorizimit për pilot testues, aplikuesi duhet të kryejë trajnim shtesë teorik e praktik (fluturim) sipas programit të aprovuar të trajnimit në organizatën e aprovuar për trajnimin e pilotëve të deltaplanit apo paraglajdit apo tek prodhuesi i deltaplanëve përkatësisht paraglajdëve apo në qendrën e specializuar për testimin e deltaplanëve përkatësisht paraglajdëve.

36.4 Pjesa teorike dhe praktike (fluturimi) e provimit për marrjen e autorizimit për pilotë testues në deltaplan apo paraglajd përmban elementet e saktësuara në Shtojcën 3 të kësaj Rregulloreje.

Neni 37 **Pranimi i licencave të huaja**

37.1 Me kërkesë të bartësit, AAC-ja mund të lëshojë licencë të Kosovës për pilotët e deltaplanit apo paraglajdit, në bazë të licencës së vlefshme të pilotit të deltaplanit apo paraglajdit që është lëshuar në shtetin e huaj.

37.2 Para lëshimit të licencës së Kosovës, bartësi i licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit të lëshuar në shtetin e huaj duhet t'i plotësojë kërkesat si në vijim:

- a) të demonstrojë nivelin e njohurisë teorike të Rregullave dhe legjislacionit në fuqi,
- b) të dorëzojë verifikimin e aftësisë së fluturimit të mbajtur nga ekzaminuesi i autorizuar,
- c) të posedojë certifikatën e vlefshme të gjendjes shëndetësore,
- d) të ketë përfunduar së paku 30 orë kohë të përgjithshme të fluturimit në deltaplan përkatësisht në paraglajd.

37.3 Me kërkesë të bartësit, AAC-ja mund ta validojë licencën e jashtme të pilotëve të deltaplanit përkatësisht paraglajdit apo autorizimin përkatës. Periudha e vlefshmërisë së validimit nuk guxon të jetë më e gjatë se një vit apo deri në skadimin e vlefshmërisë së licencës primare apo të autorizimit përkatës.

Neni 38
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 10 tetor 2012.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm

SHTOJCA 1

STANDARDET REFERUESE PËR PRODHIMIN DHE EKZEKUTIMIN E SHQYRTIMIT TEKNIK PER DELTAPLAN DHE PARAGLAJD

- EN 926-1 dhe EN 926-2 (*Normat Evropiane*):
- LTF 2009: Standardet e lëshuara nga Agjencioni i Aviacionit Civil të Gjermanisë [*Luftfahrt-Bundesamt (LBA)*], në pajtim me EN 926-2 të publikuar në NfL II 91/09 [*Nachrichten Für Luftfahrer*].

Nëse nuk janë në kundërshtim me standardet e lartpërmendura, standardet kombëtare për Deltaplan dhe paraglajd mund të merren parasysh në përputhje me:

- *Deutscher Hängegleiter Verband (DHV)*: Asociacioni Gjerman për Deltaplan dhe paraglajd;
- *Schweizerischer Hängegleiter Verband (SHV)*: Asociacioni Zvicëran për Deltaplan dhe paraglajd;
- *Association française de Normalisation (AFNOR)*: Asociacioni Francez për standardizim,
- *British Hang Gliding and Paragliding Association (BHPA)*: Asociacioni Britanik për Deltaplan dhe paraglajd;
- *Deutscher Ultraleichtflugverbandes (DULV)*: Asociacioni Gjerman i pilotëve të mjeteve ajrore mikro të lehta;
- *European Hang Gliding and Paragliding Union (EHPU)*: Unioni Evropian për Deltaplan dhe paraglajd;
- *FAI Sporting Code Section 7B – Class O*: Rregulloret e Federatës Ndërkombëtare të Aeronautikës (FAI) mbi garat me Deltaplan dhe paraglajd.

SHTOJCA 2

KORNIZA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT

Korniza e programit të trajnimit numëron orët e trajnimit teorik dhe numrin e fluturimeve praktike gjatë trajnimit duke theksuar minimumin e orëve të kërkuara për trajnim të mirëfilltë të secilit kandidat.

A. KORNIZA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT PËR DELTAPLAN

1. Trajnimi për të përvetësuar licencën e pilotit për Deltaplan (SOLO)

Bazuar në kornizën e programit, trajnimi përbëhet nga dy faza themelore si në vijim:

Faza e parë - Pjesa teorike (20 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 4 orë
- b) Ndërtimi dhe materialet - 3 orë
- c) Meteorologjia - 4 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- e) Teknikat e fluturimit - 2 orë
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 2 orë
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 2 orë
- h) Testi - 1 orë

Faza e parë - Pjesa praktike (10 - 20 trajnime)

- a) Transporti, magazinimi dhe manipulimi i Deltaplaneve dhe pajisjeve - 1 orë
- b) Montimi dhe ç'montimi i Deltaplanit - 1 orë
- c) Kontrolli i Deltaplanit dhe sistemit të telave para fluturimit- 1 orë
- d) Pozicionimi i sigurtë gjatë rënies - 1 orë
- e) Kontrollimi i Deltaplanit në tokë - 1 orë
- f) Ushtrimet në sipërfaqe të rrafshët - 4 orë
- g) Ushtrimet në fushën e trajnimit – ushtrimi i ngritjes pa u ngritur - 1 orë
- h) Ushtrimet në kodrën për trajnime:
 - Vrapimi për ngritje, kërcim deri në 1 m lartësi mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi i ngritjeve dhe atertimeve) - 10 fluturime
 - Vrapimi për ngritje, kërcim deri në 5 m lartësi mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi i ngritjeve dhe atertimeve) - 20 fluturime
- i) Ushtrimet në fushën e trajnimit:
 - Fluturimet që arrijnë lartësi prej 10 m mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi i ngritjeve dhe atertimeve) - 20 fluturime

- Fluturimet që arrijnë lartësi prej 30 m mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi i shpejtësisë dhe kontrollit të drejtimit) - 10 fluturime
- Fluturimet që arrijnë lartësi prej 50 m mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi i kontrollit të shpejtësisë dhe ndërrimit të drejtimit) - 10 fluturime

Në fazën e parë të trajnimit kandidati përvetëson njohuritë e nevojshme teorike mbi konceptet, parimet dhe rregullat themelore të përdorimit të Deltaplanit. Pjesa teorike përfundon me provim me shkrim të brendshëm që përmban 50 detyra, ndërsa norma për të kaluar provimin duhet të jetë së paku 75% saktësi.

Faza e dytë - pjesa praktike (60 Fluturime)

- a) Fluturimi në lartësi të larta - xhirimi, planifikimi, xhiro për aterrim - 10 fluturime
- b) Velorimi në shpat (pjerrtësi) (nëse është e aplikueshme) - 5 fluturime
- c) Velorimi në termale (nëse është e aplikueshme) - 10 fluturime
- d) Përgatitjet për test - 1 fluturim

2. Trajnimi për të përvetësuar licencën e pilotit për Deltaplan (TANDEM)

Bazuar në kornizën e programit, trajnimi përbëhet nga dy faza themelore si në vijim:

Faza e parë - Pjesa teorike (20 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 4 orë
- b) Ndërtimi dhe materialet - 3 orë
- c) Meteorologji - 4 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- e) Teknikat e fluturimit - 2 orë
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 2 orë
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 2 orë
- h) Testi - 1 orë

Faza e parë - Pjesa praktike (10 - 20 trajnime)

- a) Transporti, magazinimi dhe manipulimi i Deltaplans dhe pajisjeve - 1 orë
- b) Montimi dhe çmontimi i Deltaplanit - 1 orë
- c) Kontrolli i Deltaplanit dhe sistemit të telave para fluturimit - 1 orë
- d) Pozicionimi i sigurtë gjatë rënies - 1 orë
- e) Kontrollimi i Deltaplanit në tokë - 1 orë
- f) Ushtrimet në sipërfaqe të rrafshët - 4 orë
- g) Tandem - fluturimi informues - 1 orë
- h) Tandem (ngritja, kthimet, xhirimet, planifikimi, xhiro për të aterruar) - 20 fluturime

- i) Ushtrimet në fushën e trajnimit – ushtrimi i ngritjes pa u ngritur - 1 orë
- j) Ushtrimet në kodrën për trajnime:
 - Vrapimi për ngritje, kërcim deri në 1 m lartësi mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi i ngritjeve dhe atertimeve) - 5 fluturime
- k) Ushtrimet në fushën e trajnimit:
 - Fluturimet që arrijnë lartësi prej 10 m mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi i ngritjeve dhe atertimeve) - 5 fluturime
 - Fluturimet që arrijnë lartësi prej 30 m mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi i kontrollit të shpejtësisë dhe drejtimit) - 5 fluturime
 - Fluturimet që arrijnë lartësi prej 50 m mbi sipërfaqe të tokës (ushtrimi për kontrollimin e shpejtësisë dhe ndërrimit të drejtimit) - 5 fluturime

Në fazën e parë të trajnimit kandidati përvetëson njohuritë e nevojshme teorike mbi konceptet, parimet dhe rregullat themelore të përdorimit të Deltaplanit. Pjesa teorike përfundon me provim me shkrim të brendshëm që përmban 50 detyra dhe norma për të kaluar provimin duhet të jetë së paku 75% saktësi.

Faza e dytë - pjesa praktike (60 Fluturime)

- a) Fluturimi në lartësi të larta – xhirimi, planifikimi, xhiro për aterrim - 10 fluturime
- b) Velorimi në shpat (pjerrtësi) (nëse është e aplikueshme) - 5 fluturime
- c) Velorimi në termale (nëse është e aplikueshme) - 10 fluturime
- d) Përgatitjet për test - 1 fluturim

3. Trajnimi për lëshimin e privilegjeve për instruktor të Deltaplanit

Trajnimi për lëshimin e privilegjeve për instruktor të Deltaplanit nënkupton praninë në gjithë pjesën teorike dhe praktike si dhe stazh nën mbikëqyrjen e instruktorit të certifikuar në ndonjë organizatë trajnimit të aprovuar.

Pjesa teorike (25 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) – 3 orë
- b) Ndërtimi dhe materialet - 2 orë
- c) Meteorologji - 4 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 3 orë
- e) Teknikat e fluturimit - 2 orë
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 3 orë
- g) Ligjërimi i metodologjisë dhe psikologjisë - 4 orë
- h) Ofrimi i ndihmës së parë - 4 orë

Pjesa praktike

- a) Trajnimi në terren: kontrollimi i shkathtësive, metodologjia e ligjërimit - 4 orë
- b) Trajnimi në lartësi të ulëta dhe mesatare: kontrollimi i shkathtësive, metodologjia e ligjërimit - 10
- c) Trajnimi në lartësi të larta: kontrollimi i shkathtësive, metodologjia e ligjërimit - 5

4. Trajnimi për lëshimin e privilegjeve për fluturim tandem

Pjesa teorike (16 orë) *(nuk është obligative për kandidatët të cilët posedojnë privilegjet për instruktor fluturimi)*

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 2 orë
- b) Meteorologji - 4 orë
- c) Rregullat dhe rregulloret - 3 orë
- d) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 3 orë
- e) Ofrimi i ndihmës së parë - 4 orë

Pjesa praktike

Së paku 10 fluturime me Deltaplan tandem në lartësi të larta nën mbikëqyrjen e instruktorit të fluturimeve dhe pasagjeri së paku të ketë licencë piloti për Deltaplan.

5. Trajnimi për lëshimin e privilegjeve për pilot testues

Pjesa teorike (20 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 2 orë
- b) Ndërtimi dhe materialet - 2 orë
- c) Meteorologji - 4 orë
- d) Ligjërimi i metodologjisë dhe psikologjisë - 5 orë
- e) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 5 orë

Pjesa praktike

Fluturime me së paku 5 lloje të ndryshme të Deltaplaneve - 20 orë

6. Trajnimi për lëshimin e privilegjeve për fluturim akrobatik

Pjesa teorike (18 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 2 orë

- b) Ndërtimi dhe materialet - 2 orë
- c) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- d) Teknikat e fluturimit - 4 orë
- e) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 4 orë
- f) Ofrimi i ndihmës së parë - 4 orë

Pjesa praktike

- a) Trajnimi në terren: bazat e manovrave akrobatike - 4 orë
- b) Procedurat e emergjencës gjatë fluturimit akrobatik - 10 fluturime
- c) Manovrat akrobatike - 20 fluturime

7. Trajnimi për zgjerimin e privilegjeve për ngritje nga kodrat

Pjesa teorike (10 orë)

- a) Metoda të ndryshme të ngritjes nga kodra - 2 orë
- b) Teknikat e fluturimit në shpat - 2 orë
- c) Situatat e rrezikshme - 2 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- e) Fushat për ngritje dhe aterrim - 2 orë

Pjesa praktike

- a) Ushtrimet në terren - 2 orë
- b) Fluturimi në 3 aerodrome të ndryshme, së paku - 10 fluturime
- c) Organizimi i fluturimit në fushën për ngritje - 10 fluturime

8. Trajnimi për zgjerimin e privilegjeve për ngritje duke përdorur rimorkim (vinç stacionar apo vinç mobil apo linjë statike)

Pjesa teorike (12 orë)

- a) Pajisjet (ndërtimi i vinçit, litari për rimorkim, hallka e dobët, radio komunikimi, pajisja për shkëputje , karroca për ngritje) - 2 orë
- b) Teoria e fluturimit (parimet fizike të rimorkimit) - 2 orë
- c) Teknikat e fluturimit gjatë tërheqjes ("Start i sigurtë", teknikat e ngritjes, shkëputja) - 2 orë
- d) Situatat e rrezikshme - 2 orë
- e) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- f) Aeroportet - 2 orë

Pjesa praktike

- a) Ushtrimet në terren - 2 orë

- b) Fluturimi deri në 300 m duke përdorur pajisjen për shkëputje - 10 fluturime
- c) Organizimi i fluturimit me përdorim të pajisjeve për rimorkim - 10 fluturime

9. Trajnimi për zgjerimin e privilegjeve për ngritje duke përdorur vinç

Pjesa teorike (12 orë)

- a) Pajisjet (ndërtimi i vinçit, litari për rimorkim, hallka e dobët, radio komunikimi, pajisja për shkëputje) - 2 orë
- b) Teoria e fluturimit (parimet fizike të rimorkimit) - 2 orë
- c) Teknikat e fluturimit gjatë tërheqjes (teknikat e ngritjes, shkëputja) - 2 orë
- d) Situatat e rrezikshme - 2 orë
- e) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- f) Aeroportet - 2 orë

Pjesa praktike

- a) Ushtrimet në terren - 2 orë
- b) Fluturime me përdorim të pajisjes për çkapje - 10 fluturime
- c) Organizimi i fluturimit me përdorim të pajisjeve për rimorkim - 10 fluturime

10. Trajnimi për zgjerimin e privilegjeve për ngritje duke përdorur motor

Pjesa teorike (12 orë)

- a) Teoria e fluturimit (parimet fizike gjatë ngritjes dhe fluturimi me përdorim të motorit) - 2 orë
- b) Dizajnimi dhe ndërtimi i Deltaplanve me motor - 2 orë
- c) Teknikat e fluturimit me motor - 2 orë
- d) Situatat e rrezikshme - 2 orë
- e) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- f) Aeroportet - 2 orë

Pjesa praktike

- a) Ushtrimet në terren (nxitimi testues dhe ngrohja e motorit) - 1 orë
- b) Fluturimi deri në lartësi prej 30 m - 5 fluturime
- c) Fluturimi deri në lartësi prej 300 m - 5 fluturime
- d) Organizimi i fluturimit gjatë ngritjes me motor - 10 fluturime

11. Trajnimi dhe seminarët për rifreskimin e njohurive për zgjerimin e privilegjeve

Zgjerimi i privilegjeve, përveç tjerash (fluturimet e rregullta, gjendja - shëndetësore), sipas kësaj rregullore do të thotë azhurnim dhe rifreskim i rregullt i njohurive. Rifreskimi i njohurive bëhet nëpërmes seminareve profesionale të organizuara nga ndonjë organizatë e aprovuar për trajnim. Seminarët përfshijnë pjesën teorike përderisa pjesa praktike është opcionale por e mundshme.

Përmbajtja e kursit duhet të caktohet në pajtim me kërkesat dhe temat aktuale.

Pas përfundimit të trajnimit apo seminarit për rifreskim të njohurive, organizata e aprovuar për trajnim duhet të ju lëshojë pjesëmarrësve certifikata të pjesëfitimit që do të shërbejë si dëshmi për zgjerimin e privilegjeve.

B. KORNIZA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT PËR FLUTURIME ME PARAGLAJD

1. Trajnimet për përvetësimin e licencës së pilotit për paraglajd

Bazuar në kornizën e programit, trajnimi përbëhet nga dy faza themelore si në vijim:

Faza e parë - pjesa teorike (20 orë)

- a) Hyrje - 1 orë
- b) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 2 orë
- c) Ndërtimi dhe materialet - 2 orë
- d) Meteorologji - 4 orë
- e) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- f) Teknikat e fluturimit - 2 orë
- g) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 3 orë
- h) Ofrimi i ndihmës së parë - 4 orë

Faza e parë - Pjesa praktike (10 - 20 trajnime)

- a) Familjarizimi dhe manipulimi me pajisjet, përgatitja e fluturimit - 1 orë
- b) Ngritja e krahut (Sipërfaqja e epërme) - 3 orë
- c) Manipulimi me paraglajd në tokë - 3 orë
- d) Faza e ngritjes dhe shkëputja nga toka - 3 orë
- e) Fluturimet në lartësi të ulëta deri në 10 m: ushtrimi i ngritjeve dhe atertimeve - 10-15 fluturime

- f) Fluturimet në lartësi të ulëta deri në 30 m: ushtrimi i ngritjeve dhe atertimeve - 10-15
- g) Fluturimet në lartësi të ulëta deri në 50 m: kthesa të vogla, kthesa 180 °, plani i aterimit - 20-30 fluturime
- h) Fluturimet në lartësi mesatare: kthesat, xhirimet, plani i aterimit - 10 fluturime
- i) Lansimi mbrapa: teknika e kontrollit të kryqëzuar dhe teknikat e përdorimit të ngritësve A dhe D - 3 orë
- j) Kontrollat e fluturimit në lartësi mesatare - aterrimi duke përdorur xhiron për aterrim - 1-5 fluturime
- k) Fluturimet tandem me instruktorin për paraglajd - 1-2 fluturime

Në fazën e parë të trajnimit kandidati përvetëson njohuritë e nevojshme teorike mbi konceptet, parimet dhe rregullat themelore të përdorimit të paraglajdëve. Pjesa teorike përfundon me provim me shkrim të brendshëm që përmban 50 detyra, ndërsa norma për të kaluar provimin duhet të jetë së paku 75% saktësi.

Faza e dytë - Pjesa teorike (20 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 2 orë
- b) Ndërtimi dhe materialet - 2 orë
- c) Meteorologji - 4 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- e) Teknikat e fluturimit - 3 orë
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 4 orë
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 2 orë
- h) Testi - 1 orë

Faza e dytë - Pjesa praktike (60 Fluturime)

- a) Lansimi mbrapa - 3 orë
- b) Fluturimet në lartësi të larta: familjarizimi me lartësi të larta, xhirimi, planifikimi, dhe xhiro për të ateruar - 5 fluturime
- c) Fluturimet në lartësi të larta: njohja e rrymave të ajrit, terrenit dhe mjeteve ajrore tjera, kthesat "tetëshet" dhe rrotullimet (rrotullimi 360°) - 5 - 10 fluturime
- d) Velorimi në shpat (nëse është e aplikueshme) - 5 - 10 fluturime
- e) Kontrolla e bartjes së peshës dhe linjat D - 2-3 fluturime
- f) Mbylljet laterale: simetrike ("veshët") dhe të njëanshme - 3-5 fluturime
- g) Velorimi në termale të mesme (nëse është e aplikueshme) - 10-15 fluturime
- h) Zbritje e shpejtë duke përdorur manovrën "B-stall" dhe spiralen e butë - 5 fluturime
- i) Velorimi në termale të larta (nëse është e aplikueshme) 10-15 fluturime
- j) Spirale të ashpra - 2-3 fluturime
- k) Mbifluturimet - 10-15 fluturime

l) Përgatitjet për provim - 2-3 fluturime

Në pjesën teorike të fazës së dytë kandidati plotëson njohuritë e fazës së parë përdorur trajnimi praktik përfshin fluturimet në lartësi të larta. Kontrollimi preliminar i brendshëm i njohurive përmban 50 pyetje dhe norma e suksesit është 75% saktësi.

2. Trajnimi për lëshimin e privilegjeve të instruktorit për paraglajd

Trajnimi për lëshimin e privilegjeve të instruktorit për paraglajd parasheh prezencë të plotë në pjesën teorike dhe praktike, si dhe një praktikë në ndonjë organizatë të aprovuar për trajnim nën mbikëqyrjen e instruktorit të certifikuar për fluturime.

Pjesa teorike (25 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 3 orë
- b) Ndërtimi dhe materialet - 2 orë
- c) Meteorologji - 4 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 3 orë
- e) Teknikat e fluturimit - 2 orë
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 3 orë
- g) Mësimi i metodologjisë dhe psikologjisë - 4 orë
- h) Ofrimi i ndihmës së parë - 2 orë

Pjesa praktike

- a) Trajnimi në terren: kontrolli i shkathtësive, metodologjia e ligjërimit, manipulimi në tokë - 4 orë
- b) Trajnimi në lartësi të ulëta dhe mesatare: kontrolli i shkathtësive, metodologjia e ligjërimit - 10 fluturime
- c) Trajnimi në lartësi të larta: kontrolli i shkathtësive, metodologjia e ligjërimit - 5 fluturime
- d) Procedurat e emergjencës: S.I.V. Trajnimi - 2-3 fluturime

3. Trajnimi për të përvetësuar autorizimin për fluturime dyshe (tandem)

Pjesa teorike (20 orë) (nuk kërkohet për kandidatët të cilët posedojnë licencë valide të instruktorit)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 2 orë
- b) Ndërtimi dhe materialet - 2 orë
- c) Meteorologji - 4 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 3 orë
- e) Teknikat e fluturimit - 2 orë

- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 3 orë
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 4 orë

Pjesa praktike

- a) Trajnimi në terren: kontrolli i shkathtësive, manipulimi në tokë - 2 orë
- b) Fluturimet dyshe me paraglajd në lartësi të ulëta dhe të mesme, nën mbikëqyrjen e instruktorit të fluturimit dhe pasagjeri duhet të ketë të paktën licencën për pilot për paraglajd - së paku 10 fluturime
- c) Procedurat e emergjencës: S.I.V. Trajnimi - 2-3 fluturime

4. Trajnimi për të përvetësuar autorizimin për pilot testues

Pjesa teorike (20 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - nivel i lartë - 5 orë
- b) Strukturat dhe materialet - 5 orë
- c) Kriteret dhe metodat e testimit - 5 orë
- d) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 5 orë

Pjesa praktike

- a) Fluturime me së paku 5 paraglajdë të ndryshëm - 20 orë
- b) Procedurat e emergjencës: S.I.V. Trajnimi - së paku - 5 fluturime

5. Trajnimi për të përvetësuar autorizimin për fluturime akrobatike

Pjesa teorike (20 orë)

- a) Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 2 orë
- b) Ndërtimi dhe materialet - 2 orë
- c) Meteorologji - 2 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- e) Teknikat e fluturimit - 4 orë
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 4 orë
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 4 orë

Pjesa praktike

- a) Trajnimi në terren: bazat e manipulimit në terren të manovrave akrobatike - 4 orë
- b) Procedurat e emergjencës: S.I.V. së paku 10 fluturime
- c) Manovrat akrobatike së paku - 20 fluturime

6. Trajnimi për përvetësimin e privilegjeve për ngritje nga kodrat

Pjesa teorike (10 orë)

- a) Metodatat e ngritjes nga kodra - 2 orë
- b) Teknikat e fluturimit në shpat - 2 orë
- c) Situatat e rrezikshme - 2 orë
- d) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- e) Vendet për ngritje dhe aterrim - 2 orë

Pjesa praktike

- a) Ushtrimet në terren - 2 orë
- b) Fluturimet në së paku 3 aerodrome të ndryshme - 10 fluturime
- c) Organizimi i fluturimeve dhe vendeve për ngritje - 10 fluturime

7. Trajnimi për përvetësimin e privilegjeve për ngritje me rimorkim (duke përdorur vinç stacionar apo vinç mobil apo linjë statike)

Pjesa teorike (12 orë)

- a) Pajisjet (ndërtimi i vinçit, litari për rimorkim, hallka e dobët, radio komunikimi, pajisja për shkëputje, karroca për ngritje) - 2 orë
- b) Teoria e fluturimit (parimet fizike gjatë rimorkimit) - 2 orë
- c) Teknikat e fluturimit gjatë tërheqjes ("Start i sigurtë", teknikat e ngritjes, shkëputja) - 2 orë
- d) Situatat e rrezikshme - 2 orë
- e) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- f) Aerodromet - 2 orë

Pjesa praktike

- a) Ushtrimet në terren - 2 orë
- b) Fluturimi deri në 300 m me shkëputje - 10 fluturime
- c) Organizimi i fluturimit me tërheqje - 10 fluturime

8. Trajnimi për zgjerimin e privilegjeve për ngritje duke përdorur motor

Pjesa teorike (12 orë)

- a) Teoria e fluturimit (parimet fizike të ngritjes dhe fluturimit me përdorim të motorit) - 2 orë

- b) Dizajnimi dhe ndërtimi i paraglajdëve me motor - 2 orë
- c) Teknikat e fluturimit me motor - 2 orë
- d) Situatat e rrezikshme - 2 orë
- e) Rregullat dhe rregulloret - 2 orë
- f) Aerodromet - 2 orë

Pjesa praktike

- a) Ushtrimet në terren (ndevoja testuese dhe ngrohja e motorit) - 1 orë
- b) Fluturimet deri në lartësi prej 30 m - 5 fluturime
- c) Fluturimet deri në lartësi prej 300 m - 5 fluturime
- d) Organizimi i fluturimit të ngritjes me motor - 10 fluturime

9. Trajnimi dhe seminarët për rifreskimin e njohurive për zgjerimin e privilegjeve

Zgjerimi i privilegjeve, përveç tjerash (fluturimet e rregullta, gjendja shëndetësore), sipas kësaj Rregulloreje do të thotë azhurnim dhe rifreskim i rregullt i njohurive. Rifreskimi i njohurive bëhet nëpërmes seminareve profesionale të organizuara nga ndonjë organizatë e aprovuar për trajnim. Seminarët përfshijnë pjesën teorike, përderisa pjesa praktike është opsionale por e mundshme.

Përmbajtja e kursit duhet të caktohet në pajtim me kërkesat dhe temat aktuale.

Pas përfundimit të trajnimit apo seminarit për rifreskim të njohurive, organizata e aprovuar për trajnim duhet t'ju lëshojë pjesëmarrësve certifikata të pjesëfitimit që do të shërbejnë si dëshmi për zgjerimin e privilegjeve.

SHTOJCA 3

PROGRAMET PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE PËR FITIMIN E LICENCËS DHE AUTORIZIMEVE TË PILOTIT PËR DELTAPLAN DHE PARAGLAJD.

A. PROVIMET PËR PILOT TË DELTAPLANIT

1. Ekzaminimi për fitimin e licencës së pilotit për Deltaplan

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 20 pyetje
- b) Strukturat dhe materialet - 5 pyetje
- c) Meteorologji - 15 pyetje
- d) Rregullat dhe rregulloret - 5 pyetje
- e) Teknikat e fluturimit - 10 pyetje
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 5 pyetje

Pjesa praktike

Seksioni 1: Përgatitjet dhe ngritja

- a) Inspektimi i Deltaplanit para fluturimit, dokumentimi dhe përgatitja
- b) Njohuritë mbi metodat e përdorimit të Deltaplans
- c) Kontrollimi para ngritjes

Seksioni 2: Metodatat e ngritjes *(të performojë një nga katër mënyrat e mundshme të ngritjes)*

Seksioni 2A: Ngritja nga kodrat

- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes
- b) Profili i përshtatshëm i fluturimit
- c) Simulimi i dështimit të ngritjes

Seksioni 2B: Ngritja me rimorkim nga vinçi stacionar apo vinçi mobil apo litari statik

- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes përfshirë dhe sinjalet e operatorit të vinçit
- b) Profili i përshtatshëm i fluturimit
- c) Simulimi i prishjes së rimorkimit
- d) Vetëdijesimi mbi pozicionin
- e) Shkëputja

Seksioni 2C: Ngritja duke përdorur aero - rimorkim

- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes përfshirë dhe komunikimin me pilotin e mjetit ajror që përdoret për rimorkim
- b) Nxitimi, shkëputja dhe ngritja
- c) Ndërprerja e nxitimit (simulim apo ekzaminim verbal)
- d) Përcjellja e mjetit ajror rimorkiues në fluturim linear dhe në kthesa
- e) Përmirësimi i pozitës së gabuar gjatë përcjelljes
- f) Shkëputja

Seksioni 2D: Ngritja duke përdorur motorë

- a) Procedurat për ngritje në aeroport,
- b) Nxitimi, shkëputja dhe ngritja
- c) Monitorimi i fluturimit dhe shkathtësive të fluturimit gjatë fazës së ngritjes,
- d) Simulimi i dështimit të motorit pas ngritjes,
- e) Fikja e motorit

Seksioni 3: Aksionet e përgjithshme

- a) Mbajtja e pozitës dhe shpejtësisë në fluturim linear
- b) Koordinimi gjatë kthesave në kënd prej 30°, procedurat dhe metodat e observimit dhe shmangia e përplasjes
- c) Rimëkëmbja nga kthesat drejt pikës referuese
- d) Fluturimi nën kënde të ashpra (shpejtësi e ulët)
- e) Fluturimi me rimorkim dhe kthimi nga fluturimi me rimorkim
- f) Koordinimi gjatë kthesave në kënd prej 45°, procedurat dhe metodat e observimit dhe shmangia e përplasjes

Seksioni 4: Xhiro për aterrim, afrimi dhe aterrimi, (është e ndaluar t'i ipen instruksione kandidatit nëpërmes radios, përveç në raste emergjente)

- a) Procedurat e afrimit në xhiron për aterrim (kahja e kthimit për xhiron për aterrim mund të caktohet paraprakisht)
- b) Procedurat për monitorim dhe shmangie të përplasjes
- c) Kontrollimet para aterimit
- d) Fluturimet e xhiros për aterrim, afrimi dhe aterrimi
- e) Preciziteti i aterimit (aterrimi na zonën e caktuar mirë 100 x 50 m)

Kur të ngrihet nga kodra, një ekzaminues e kontrollon kandidatin në vendin e ngritjes, ndërsa një ekzaminues tjetër në vendin e aterimit.

2. Ekzaminimi për fitimin e privilegjeve të instruktorit të fluturimeve

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 15 pyetje
- b) Strukturat dhe materialet - 5 pyetje
- c) Meteorologji - 10 pyetje
- d) Rregullat dhe rregulloret - 5 pyetje
- e) Teknikat e fluturimit - 10 pyetje
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 5 pyetje
- h) Metodologjia e ligjërimit - 10 pyetje

Pjesa praktike

- a) Demonstrimi i ushtrimeve në terren dhe shpjegimi i fazës së ngritjes dhe kontrollimi i Deltaplanit në tokë. Kahja e kthimit për xhiron për aterrim mund të caktohet paraprakisht.
- b) Fluturimi ekzaminues për aterrim në zonën e caktuar 100 x 50 m me precizitet dhe saktësi për xhiro të aterrimit

3. Ekzaminimi për fitimin e privilegjeve për fluturim në dyshe (tandem)

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 10 pyetje
- b) Meteorologji - 10 pyetje
- c) Rregullat dhe rregulloret - 5 pyetje
- d) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje
- e) Ofrimi i ndihmës së parë - 5 pyetje

Pjesa praktike

- a) Demonstrimi i ushtrimeve në terren dhe shpjegimi i fazës së ngritjes dhe kontrollimi i Deltaplanit në tokë. drejtimi i xhiros për aterrim mund të caktohet paraprakisht,
- b) Fluturimi ekzaminues për aterrim në zonën e caktuar 100 x 50 m me precizitet dhe saktësi për xhiro të aterrimit

4. Ekzaminimi për fitimin e privilegjeve për pilot testues

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 10 pyetje
- b) Strukturat dhe materialet - 10 pyetje
- c) Kriteret dhe metodat e testimit - 10 pyetje
- d) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje

Pjesa praktike

Një fluturim në dy modele të ndryshme të Deltaplanëve (të performohen mbi sipërfaqe të ujit)

5. Ekzaminimi për fitimin e privilegjeve për fluturime akrobatike

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 10 pyetje
- b) Strukturat dhe materialet - 5 pyetje
- c) Rregullat dhe rregulloret - 5 pyetje
- d) Teknikat e fluturimit - 10 pyetje
- e) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje
- f) Ofrimi i ndihmës së parë - 5 pyetje

Pjesa praktike

Performimi i numrit të kërkuar të fluturimeve për të demonstruar manovrat akrobatike

B. PROVIMET PËR PILOT TË PARAGLAJDIT

3. 1. Ekzaminimi për fitimin e licencës së pilotit për paraglajd

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 20 pyetje
- b) Strukturat dhe materialet - 5 pyetje
- c) Meteorologji - 15 pyetje
- d) Rregullat dhe rregulloret - 5 pyetje
- e) Teknikat e fluturimit - 10 pyetje
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 5 pyetje

Pjesa praktike

Seksioni 1: Përgatitjet dhe ngritja

- a) Inspektimi i paraglajdit para fluturimit, dokumentimi dhe përgatitja
- b) Njohuritë mbi metodat e përdorimit të paraglajdit
- c) Kontrollimi para ngritjes

Seksioni 2: Metodatat e ngritjes (të performojë një nga tre mënyrat e mundshme të ngritjes)

Seksioni 2A: Ngritja nga kodrat

- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes
- b) Profili i përshtatshëm i fluturimit
- c) Simulimi i dështimit të ngritjes

Seksioni 2B: Ngritja me rimorkim nga vinçi stacionar apo vinçi mobil apo litari statik

- a) Sinjalet para dhe gjatë ngritjes përfshirë dhe sinjalet e operatorit të vinçit
- b) Profili i përshtatshëm i fluturimit
- c) Simulimi i prishjes së rimorkimit
- d) Vetëdijesimi mbi pozicionin
- e) Shkëputja

Seksioni 2C: Ngritja duke përdorur motorë

- a) Procedurat për ngritje në aeroport,
- b) Nxitimi, shkëputja dhe ngritja
- c) Monitorimi i fluturimit dhe shkathtësive të fluturimit gjatë fazës së ngritjes,
- d) Simulimi i dështimit të motorit pas ngritjes,
- e) Fikja e motorit

Seksioni 3: Aksionet e përgjithshme

- a) Mbajtja e pozitës dhe shpejtësisë në fluturim linear
- b) Rimëkëmbja nga kthesat drejt pikës referuese
- c) Manovra e zbritjes së shpejtë (nëse është e aplikueshme)

Seksioni 4: Xhiro për aterrim, afrimi dhe aterrimi, (është e ndaluar t'i ipen instruksione kandidatit nëpërmes radios përveç në raste emergjente)

- a) Procedurat e afrimit në xhiron për aterrim (drejtimi i xhiros për aterrim mund të caktohet paraprakisht)
- b) Procedurat për monitorim dhe shmangie të përplasjes
- c) Kontrollimet para aterrimit
- d) Fluturimet e xhiros për aterrim, afrimi dhe aterrimi
- e) Preciziteti i aterrimit (aterrimi në zonën e caktuar mirë 50 x 50 m)

2. Ekzaminimi për fitimin e privilegjeve të instruktorit të fluturimeve

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 15 pyetje
- b) Strukturat dhe materialet - 5 pyetje
- c) Meteorologji - 10 pyetje
- d) Rregullat dhe rregulloret - 5 pyetje
- e) Teknikat e fluturimit - 10 pyetje
- f) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje
- g) Ofrimi i ndihmës së parë - 5 pyetje
- h) Metodologjia e ligjërimit - 10 pyetje

Pjesa praktike

- a) Demonstrimi i ushtrimeve në terren dhe shpjegimi i fazës së ngritjes dhe kontrollimi i paraglajdit në tokë, dështim i kontrolluar i ngritjes, manipulimi në tokë
- b) Fluturimi ekzaminues duke performuar manovra të fluturimit për zbritje të shpejtë prej së paku 10 m/s, preciziteti dhe saktësia e aterritimit në zonën e caktuar 50 x 50 meta për xhiro të aterritimit
- c) Procedurat e emergjencës (të performuara si pjesë obligative të trajnimit S.I.V. gjatë trajnimit, kështu që kjo pjesë e trajnimit mund të anashkalohet)

3. Ekzaminimi për fitimin e privilegjeve për fluturim dyshe (tandem)

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) - 10 pyetje
- b) Meteorologji - 10 pyetje
- c) Rregullat dhe rregulloret - 5 pyetje
- d) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje
- e) Ofrimi i ndihmës së parë - 5 pyetje

Pjesa praktike

- a) Fluturimi testues i ngritjes së dështuar me paraglajd tandem në rast të ngritjes së krahut (sipërfaqja e epërme)
- b) Ngritja me paraglajd tandem me pasagjer i cili ka së paku licencën e pilotit për paraglajd
- c) Aterrimi preciz dhe saktësia e aterritimit në zonën e caktuar 50 x 50 metra për xhiro të aterritimit

4. Ekzaminimi për fitimin e privilegjeve për pilot testues

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) – 10 pyetje
- b) Strukturat dhe materialet - 10 pyetje
- c) Kriteret dhe metodat e testimit - 10 pyetje
- d) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje

Pjesa praktike

Një fluturim në dy modele të ndryshme të paraglajdëve duke performuar procedurat e emergjencës, siç janë palosja unilaterale mbi 50%, "**full-stall**", kthimi negativ, rënie spirale mbi 15 m/s (të performohet mbi sipërfaqe të ujit)

5. Ekzaminimi për fitimin e privilegjeve për fluturime akrobatike

Pjesa teorike

- a) Teoria e fluturimit (Aerodinamika dhe mekanika e fluturimit) – 10 pyetje
- b) Strukturat dhe materialet - 5 pyetje
- c) Rregullat dhe rregulloret - 5 pyetje
- d) Teknikat e fluturimit - 10 pyetje
- e) Situatat e rrezikshme dhe procedurat e emergjencës - 10 pyetje
- f) Ofrimi i ndihmës së parë - 5 pyetje

Pjesa praktike

Manovrat S.I.V dhe akrobatike: kthimi mbi krah "**wingover**", spirale asimetrike, S.A.T, kthesat negative, fluturimi i rimorkiuar, **full-stall**, **lupingu** "**looping**". Performimi i numrit të kërkuar të fluturimeve për të treguar manovrat akrobatike (të performohen mbi sipërfaqe të ujit)

SHTOJCA 4

FORMA E DITARIT TË FLUTURIMIT PËR PILOT TË DELTAPLANIT DHE PARAGLAJDIT

Ditari i fluturimit për pilot të Deltaplanit dhe paraglajdit i mundëson pilotit fluturues mbajtjen e regjistrimit të fluturimeve në mënyrë konvencionale duke siguruar të dhëna të përhershme.

Pilotët që fluturojnë mjete ajrore të kategorive të ndryshme, duhet të kenë ditar të veçantë të fluturimit për çdo kategori.

1. Të dhënat në librin e fluturimit duhet të shënohen me stilolaps apo laps, sa më shpejtë që të jetë e mundur, pas çdo fluturimi.

2. Ditari i fluturimit për Deltaplan dhe paraglajd duhet të ketë së paku këto informata:

a) Të dhënat personale:

- emri dhe mbiemri, dhe
- adresa e pronarit të ditarit të fluturimit


b) Për secilin fluturim:

- Datën e fluturimit,
- Vëndin dhe kohën e ngritjes dhe aterrimin,
- Llojin (llojin, modelin, llojin e variacionit) të Deltaplanit ose paraglajdit,
- Metodën e nisjes,
- Kohën totale të fluturimit
- Statusin gjatë fluturimit (pilot, pilot student, instruktor, kontrollor)
- Qëllimin e fluturimit dhe misionin
- Distancën e fluturuar,
- Vërejtjet dhe verifikimet.


3. Ditari i fluturimit me dimensione standarde (madhësia më e vogël është A6 deri në A4) me faqe të numëruara dhe të trasha do të jetë e pranueshme.

ANNEX 5

HANG-GLIDER PILOT LICENCE FORM



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Licencë e pilotit të deltaplanit
Dozvola pilota zmaja

Hang Glider Pilot Licence

Lëshuar në përputhje me Rregulloren XX/2012
Izdana u skladu sa Uredbom XX/2012

Issued in Accordance with the Regulation XX/2012

	Numër/Broj/Number <input style="width: 100%;" type="text"/>
	Nënshkrimi i mbajtësit Potpis imaoča Signature of Holder <input style="width: 100%;" type="text"/>
Emri dhe mbiemri/Ime i prezime/Name and Surname <input style="width: 100%;" type="text"/>	
Data dhe vendi i lindjes/Datum i mesto rodenja/DOB <input style="width: 100%;" type="text"/>	
Adresa/Adresa/Address <input style="width: 100%;" type="text"/>	
Nacionaliteti/Državljanstvo/Nationality <input style="width: 100%;" type="text"/>	
Data e lëshimit/Datum izdavanja/Date of Issue <input style="width: 100%;" type="text"/>	
Me autorizim/Po ovlaštenju/By Authority V/P/S <input style="width: 100%;" type="text"/>	

VLERËSIMET/OVLAŠTENJA/RATINGS

Data e lëshimit Datum Izdavanja Date of Issue	Nënshkrimi dhe vula Potpis i pečat Signature and Stamp
Instruktor/Nastavnik/Instructor	
I	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Pilot tandem/ Pilot tandema/Tandem Pilot	
D	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Pilot testues/Pokusni pilot/Test Pilot	
T	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Fluturime akrobatike/Akrobatsko letenje/Aerobatic Flying	
A	<input style="width: 100%;" type="text"/>
Vërejtje/Primedbe/Remarks	
<input style="width: 100%; height: 40px;" type="text"/>	

Kjo licence është e vlefshme vetëm me dëshminë mbi aftësinë mjekësore
Ova dozvola vredi samo uz dokaz o zdravstvenoj sposobnosti
This licence is valid only with evidence of medical fitness

Vlerësimet Ovlaštenje Rating	Vlefshme deri më Vredi do Valid Until	Me autorizim Po ovlaštenju By Authority
<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>
<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>
<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>
<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>
<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>	<input style="width: 100%; height: 30px;" type="text"/>
Vërejtje/Primedbe/Remarks:		
<input style="width: 100%; height: 40px;" type="text"/>		